



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:011287

Datë: 24.05.2023

Numri i dokumentit: 04319411

**APS.nr.40/2022**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – DEPARTAMENTI SPECIAL**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Bashkim Hyseni – kryetar, Vaton Durguti dhe Burim Ademi – anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, në lëndën penale ndaj të akuzuarve A.B, O.B dhe S.B, për shkak të veprës penale krim i organizuar nga neni 274 par.3 të KPK-së lidhur me veprën penale detyrim nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK-së, duke vendosur në lidhje me ankesën e Prokurorisë Speciale, ankesën dhe përgjigjen në ankesë e Prokurorisë Speciale të mbrojtësit të akuzuarit A.B av.Illir Hoxhaj, ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit O.B av.Blerina Kurtaj, si dhe ankesa e të akuzuarit S.B, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda Prishtinë, PKR.nr.15/20 i datës 31.08.2022 i datës 31.08.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.01.2023, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHEN** si të pabazuara ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës Kosovës, si dhe ankesat e mbrojtëseve e të akuzuarve A.B av.Illir Hoxhaj dhe O.B av.Blerina Kurtaj dhe ankesa e të akuzuarit S.B, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.15/20 i datës 31.08.2022 i datës 31.08.2022, **VËRTETOHET**.

## **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.15/20 i datës 31.08.2022 i datës 31.08.2022, të akuzuarit A.B, O.B dhe S.B, për shkak të veprës penale detyrim nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK-së, i ka shpallur fajtor dhe i ka gjykuar si në vijim: të akuzuarit A.B i ka shqiptuar dënimi burgimi në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite të cilin dënim do ta filloj ta mbajë 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në dënimin me burgim të akuzuarit i është llogaritur edhe koha e qëndrimit në paraburgim dhe arrest shtëpiak dhe atë prej dt. 23.12.2015 deri me dt:08.02.20218 dhe nga dt:06.05.2019 deri me dt. 31.01.2020.

Të akuzuarin O.B i ka shqiptuar dënimi burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite, të cilin dënim do ta filloj ta mbajë 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në dënimin me burgim të akuzuarit i është llogaritur edhe koha e qëndrimit në paraburgim dhe arrest shtëpiak dhe atë prej dt. 23.12.2015 deri me dt. 09.11.2017.

Të akuzuarit S.B i ka shqiptuar dënimi burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite, të cilin dënim do ta filloj ta mbajë 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në dënimin me burgim të akuzuarit i llogaritet edhe koha e qëndrimit në paraburgim dhe arrest shtëpiak dhe atë prej dt. 23.12.2015 deri me dt. 09.11.2017.

Bazuar në nenin 60 të KPK-së: të akuzuarit A.B i është konfiskuar vetura e tipit “...” me ngjyrë të zezë me targa .... dhe ....., ngjyrë të gjelbër me targa ....

Të akuzuarit O.B i është konfiskuar vetura e tipit “..”, ngjyrë të zezë me targa ..., kurse të akuzuarit O.B i janë konfiskuar të hollat në shumë prej 10.100 € (dhjetë mijë e njëqind euro).

Janë obliguar të akuzuarit që të paguajnë secili veç e veç shpenzimet e procedurës penale, dhe atë paushallin gjyqësorë në shumën prej nga 300 (treqind) euro, të gjitha në afatin prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit: Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë-AKP, M.T, K.T, H.Sh, A.H për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontestin e rregullt juridiko civil. I dëmtuari I.O nuk ka kërkesa pasurore Juridike

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë kanë ushtruar:

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga 384 par.1 nënpar.1.7 dhe 1.12 lidhur me nenin 370 par.6 dhe 7 të KPRK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 386 par. 2 të KPRK-së dhe vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovoi ankesën në tersi, ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj ashtu që të akuzuarit ti shpallë fajtor për veprat penale për të cilat janë akuzuar dhe t'iu shqiptoj dënime me të ashpra ose ta prish lëndën dhe ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.B av.Illir Hoxhaj, për shkak të shkeljes se ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe alternativisht vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoi ankesën, të zbatoj shqyrtimin gjyqësor për të përsëritur shqyrtimin e provave që të njëjtat ti vlerësoj drejtë e pas kësaj të ndryshoj aktgjykimin e ankimuar, ashtu që të akuzuarin ta liroj nga aktakuza për veprën penale Detyrim nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Mbrojtësja e të akuzuarit O.B av.Blerina Kurtaj, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 383 par.1 nënpar.1.3 lidhur me nenin 385 par.1,2 dhe 3 të KPRK-së, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoi si të bazuar ankesën, ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar konform dispozitës se nenit 364 par.1 nënpar.1.4 të KPP-së dhe ndaj të akuzuarit të shpallë aktgjykim liruese si dhe ti kthehet vetuar e konfiskuar e tipit “....., ngjyrë e zezë me targa ..... dhe të hollat në shumë prej 10.000 (dhjetëmijë e njëqind) euro.

I akuzuari S.B, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes se ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoi ankesën, pas zbatimit të shqyrtimin gjyqësor ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar, ashtu që të akuzuarin ta liroj nga aktakuza për veprën penale Detyrim nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Përgjigjeje në ankese e Prokurorisë Speciale e Republikës së Kosovë ka ushtuar mbrojtësi i të akuzuarit A.B av.Illir Hoxhaj, me propozim që ankesa e Prokurorisë Speciale e Republikës së Kosovës, të refuzohet si e pa bazuar.

Prokurori i Apelit më parashtrësën, PPA/I.nr.547/2022, datë 25.10.2022, ka propozuar që të aprovohet ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës si të bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet sa i përket kualifikimit juridik, në atë mënyrë që të akuzuarit të shpallën fajtor për veprat penale si në aktakuzë dhe t'iu shqiptohen dënime me burgim me kohëzgjatje me të lartë se sa në aktgjykimin e ankimuar apo aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje, kurse ankesa dhe përgjigjja në ankesë e mbrojtësit të akuzuarit A.B av.Illir Hoxhaj ankesa e mbrojtësit të akuzuarit O.B av.Blerina Kurtaj si dhe ankesa e të akuzuarit S.B të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata e Apelit e caktoi dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPK-se në të cilën kanë marrë pjesë, të dëmtarit M. T.a, K. T, dhe H.Sh dhe përfaqësuesi i të dëmtuarve av.Faton Hyseni, të akuzuarit A.B, O.B dhe S.B, dhe mbrojtësit e tyre av.Illir Hoxhaj, av.Blerina Kurtaj dhe av.Agron Kuqi, ndërsa nuk kanë prezantuar Prokurori i Apelit, e dëmtuara Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe të dëmtuarit A.H dhe I.O edhe pse janë njoftuar në mënyrë të rregullt nuk morën pjesë në seancë. Përfaqësuesi i të dëmtuarve av.Faton Hyseni, ka propozuar që ankesa e PS të aprovohet si e bazuar dhe të akuzuarve t'iu shqiptohen dënime më i ashpra, ndërsa të dëmtuarit M.T, K.T dhe H.Sh, e mbështeten përfaqësuesin e tyre, ndërsa mbrojtësi e të akuzuarve pasi elaboruan ankesat theksuan se mbetën në tërësi pran pretendimeve ankimore të paraqitura me shkrim, ndërsa të akuzuarit i mbështetin mbrojtësit e tyre.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet ankimore të Prokurorisë të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, së bashku me shkresat tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

#### **Ankesat nuk janë të bazuara.**

Në ankesën Prokuroria Speciale të Republikës Kosovës, pretendon se aktgjykimi i ankimuar është përshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.7 të KPPRK-së, dhe për kundër insistimit të vazhdueshëm të prokurorisë dhe për kundër një mori provash që vërtetojnë pa dyshim se pronësia e parcelës kontestuese ka kaluar në pronësi private nëpërmjet dokumenteve të falsifikuara gjykata e shkallës së parë përsëri mbyllë sytë dhe ia mundëson krimineleve përvetësim e kundërligjshëm dhe lejon qe toka të mbetet në emër të 6

bashkëpronareve formal, familjareve të të akuzuarve të cilat fare nuk kanë lidhje me pronën. Në faqen 35 të aktgjykimit numërohen provat të cilat vërtetojnë faktin se kalimi i pronësisë nga shoqërore në atë private është kryer në bazë të dokumentit të falsifikuar. Përpos provave të mbledhura gjykata ka siguruar edhe prova shtesë gjatë gjykimit-përgjigjen e administratorit të Gjykatës Themelore në Prishtinë me të cilën vërtetohet se fare nuk është zhvilluar kontesti civil gjatë vitit 1996 me të cilin M. M. i është kthyer në pronësi parcela kontestuese, si dhe komplet dosja e lëndës C.... të Gjykatës Supreme me të cilin vërtetohet fakti i njëjtë. Megjithëse gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë asnjë vendim lidhur me kërkesën e prokurorisë që të anulohen të gjitha veprimet juridike të ndërmarra sipas dokumenteve të falsifikuara edhe pse ka pasur prova të mjaftueshme bazuar në këtë Gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar sipas nenit 370 par.6 nuk paraqiti arsye për çdo pikë të aktgjykimit e më tutje citon dispozitën e nenit 370 par.7 të KPPRK-së, duke theksuar se në rastin konkretë gjykata është koncentruar vetëm në elementet e veprës penale të Detyrimit dhe tërësisht i ka shpërfillur një seri të veprimeve sekondare, kundërligjore të akuzuarve, të cilat të njëjtit i kanë ndërmarr me qëllim që ta përvetësojnë tokën në fjalë. Mirëpo, këto veprime përmbajnë elemente të shumë veprave të ndryshme penale, që janë kryer në kontinuitet brenda shumë viteve dhe nuk guxojnë të anashkalohe. Shkëputja e veprimeve të caktuara nga tërësia e tyre kohore dhe përmbajtjesore ka rezultuar me një vendim të gabuar dhe të padrejtë. Ka shtuar se dispozitivi i aktgjykimit në mënyrë drastike është shkurtuar, i privuar nga shumë fakte të vërtetuar të cilat kanë ndikuar në marrjen e aktgjykimit në kundërshtim me provat dhe lidhur me këtë i referohet pjesëve të caktuar ta aktgjykimit të përfshira në faqen 36 pasus i 4 dhe faqen 35 pasus i 2 se çka ka konstatuar gjykata në aktgjykim, mirëpo prokurori cek se dispozitivi i aktgjykimit fillon nga viti 2012, duke anashkaluar plot 8 vite gjatë të cilave ky grup i organizuar kriminalë ka kryer shumë vepra të ndryshme penale të cilat edhe vetë gjykata i përmend në arsyetim. Pra sipas aktgjykimit vepra penale e detyrimit është kryer 2012-2014 kurse në arsyetim konstaton se veprimet e të akuzuarve kanë shkuar duke u përshkallëzuar....., kurse në anën tjetër të akuzuari nuk i fajëson e sa nuk i dënon as për veprimet e kundërligjshëm qe ajo vet i thekson në dispozitiv, kjo nga shkak se të njëjtit i ka shpallur fajtor vetëm për një vepër pa e respektuar nenin 81 për veprat penale në vazhdim.

Lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ka theksuar se edhe pse në këtë rast penal gjendja faktike është e qartë dhe e mbështetur me prova të mjaftueshme për çdo element të veprave penale aktgjykimi bazohet në konkludimet e gabuara, ku disa prej provave të administruar fare nuk i ka përmendur e disa prej tyre janë përmendur por nuk janë vlerësuar, ku mes tjerash gjykata fare nuk jep vlerësimin e mbrojtjes së të akuzuarve e as deklaratave të

dëshmitarëve të tyre ku të gjitha kanë dhënë deklaratë jashtëzakonisht kontradiktore, përveç kësaj as dëshmitarët si blerës formal e as të akuzuarit nuk kanë qenë në gjendje të ofrojnë prova lidhur me mënyrën e blerjes së tokës, çmimit etj, ndërsa të akuzuarit me R.Sh i përmend si pronar, pastaj investitor, aksionar, bashkëpunëtorë..., gjithashtu ndryshimi në librat kadastral të akuzuarit i kanë kryer në bazë të dokumenteve të falsifikuara dhe për këtë janë siguruar shumë prova por që gjykata i ka anashkaluar. Ka shtuar se gjatë hetimit është siguruar shkresa e Kryetarit të Gjykatës supreme me të cilën vërtetohet se është falsifikuar aktgjykimi C.nr.295/96 sipas se cilit kombinati “Bujqësia” obligohet që M. M të ia kthej në pronësi ngastrën kadastrale 1539/1, pastaj prokurori i referohet provave të tjera me të cilat vërtetohen se ndryshimet kadastrale janë bërë në mënyrë të kundërligjshme dhe të gjitha këto prova padyshim vërtetojnë së aktgjykimi P.nr.395/96 në bazë të të cilit komplet ngastra 1563 ka kaluar se pari në emër të M. M e pastaj në emër të 6 familjareve të të akuzuarave. Megjithatë gjykata nuk e sheh të nevojshëm të përmend dhe i vetmi koment për prova të cekura si me lartë është me sa vijon; *“pas analizimit të kësaj dosje shihet qartë se njëri nga paditësit është edhe M.M, ndërsa e paditura PTK Export-Import, por deri me tani nuk ka marr epilog ky rast.* Në vazhdim të aktgjykimit në shkallës së parë gabimisht ka konstatuar se nuk është kryer vepra penale krim i organizuar nga neni 274 të KPK-së, ndërsa konkludimi i shkallës së parë në raport me këtë veprë penale është i palogjikshëm dhe tuje paraqet argumentet në raport me veprën penale krim i organizuar, ndërsa sipas prokurorisë argumenti tjetër për lirim e të akuzuarve nga vepra penale krim i organizuar nga shkalla e parë është se ky grup nuk mund të konsiderohet si strukturë....., dhe se të akuzuarit kanë vepruar si anëtarë të grupit në vrasje të rrethanave, mirëpo lidhur me kohëzgjatjen e ekzistimit dhe strukturën e grupit të organizuar kriminal vetë gjykata e konstaton faqen 35 pasusi 2 “ se nga dëshmia e dëshmitarit të dëmtuarit M është vërtetuar edhe fakti se shfrytëzimin e pa penguar të pronës e ka gëzuar deri në vitin 2004, ndërsa prej asaj kohe janë shfaqur i akuzuari A.B, bashkë me S.. dhe O.B”, pastaj dëshmitarja H.Sh ka deklaruar se O.B ka filluar me u marrë me këtë punë në vitin 2003 apo 2004, po ashtu të gjithë të dëmtuarit kanë dhënë deklaratë të cilat janë në pajtueshmëri të plotë reciproke. Pastaj agrumet shtesë sipas gjykatës për mos ekzistim e krimin të organizuar është që disa prej tyre kanë lidhje familjare, ndërsa sipas prokurorisë kjo është një karakteristik e gupeve të organizuara kriminale, kurse në shqyrtimin gjyqësor vetë të akuzuarit kanë dorëzuar një provë shtesë që dëshmohet ekzistimi i këtij grupi dhe qëllimi i tyre se paku nga viti 2004 është fjala për marrëveshjen e dt... shkurt 2.. mes të akuzuarit A.B dhe S.Sh ku si shitës paraqitet A.B i cili formalisht dhe juridikisht kurrë nuk ka figuruar si pronar i tokës, por kjo marrëveshje nënkupton se ai e ka konsideruar vetën si pronar ndërsa anëtarët e tjerë të grupit e kanë konsideruar të akuzuarin Arbën si bos si person i cili disponon me prone e përvetësuar, ndërsa

bindja e të akuzuarave se kanë përvetësuar tokën ka qenë aq e fortë saçe e kanë bërë marrëveshjen një muaj pra se toka është regjistruar në emrin e M. M dhe para se i njëjti kinse atë iu ka shitur familjareve të të akuzuarve, dhe ky fakt dëshmon seriozitetin dhe stabilitetin e grupit. Nga kjo është e qartë së bosi ka qenë A.B dhe i njëjti ka qenë në shtëpinë e M.M dhe i ka ofruar përftim material (dëshmia e dëshmitarit D. M), autorizimi i falsifikuar është në emër të A. B, dhe të gjitha shkresat me të cilat janë kërkuar ndryshmet kadastrale janë të nënshkruara nga ai akuzuari Arben, po ashtu i njëjti e ka kërcënuar juristin e Kombinatit “...a”, I.O, me kidnapimin e djalit të tij, pastaj njoftimi për lirim e objekteve është nënshkruar nga i akuzuari A.B, kurse i dëmtuari M.T, disa herë ka cituar fjalët e të ndjerit R.Sh i cili ka thënë *se toka është e A dhe unë dhe O i kemi nga dy hektar tokë si shpërblim nga A*, çka do të thotë së në përputhje me rolin e tij i akuzuari Ai ka kryer të gjitha veprimet kyçe dhe i ka drejtuar veprimet e anëtareve të tjerë të grupit, ndërsa dora e djathtë e tij ka qenë R.Sh i cili i ka kryer punët e pista brenda grupit, ndërsa sipas masave të fshehta bashkëpunëtori me i ngushtë i të akuzuarit A, ka qenë i akuzuari O.B. Po ashtu cek së gjykata në faqen 47 të aktgjykimit gabimisht thekson se nuk është vërtetuar se një prej viktimave të këtij grupi kriminal ka qenë i dëmtuari A.H ashtu që lidhur me këtë i referohet deklaratës së të dëmtuarit, duke shtuar se përkitazi me këtë është zhgënjyes logjika e shkallës së parë e cila si argument për mosekzistimin e veprës se detyrimit e merr faktin se ky rast është mbyllur nga ana e prokurorisë e cila në bazë të dokumenteve të falsifikuar të ofruara të ofruar nga të akuzuarit ka konkluduar së është fjala për kontest juridiko civil. Tutje ka shtuar se është i pa pranueshëm arsyetim i shkallës së parë e cila të akuzuarit i amnistion për të gjitha veprimet e kryera në dëm të të dëmtuarit A.H, për faktin në mënyrë të caktuar të akuzuarit e kanë detyruar të dëmtuarin A.H të ia bëjë edhe një pagës, kësaj radhe prej 115 mijë euro, ndërsa sipas gjykatës i dëmtuari me dëshirë iu ka falë të akuzuarave shumë prej 165 mijë euro, prandaj të gjitha këto fakte veç e veç dhe në raport reciprok, dëshmojnë se të akuzuarit gjatë periudhës me shumë së 10 vjeçare kanë vepruar si grup i organizuar, stabil dhe i strukturuar duke kryer shumë vepra penale me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore ashtu që në veprime e tyre janë përmbushur të gjitha elementet e veprës penale krim i organizuar nga neni 274 të KPK-së.

Vendimi mbi sanksionin penal, thekson se është minimal dhe absolutisht i pa pranueshëm për shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve, pasi që vepra penale është kryer në vazhdimësi gjatë periudhës shumë vjeçare, ndërsa sanksioni penale është tepër i butë e madje vetëm për një vepër penale, i cili është në kundërshtim edhe me direktivën e dhëna në udhëzuesin, për politikën ndëshkimore të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lart.

Në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit A.B av.Illir Hoxhaj, lidhur me shkeljen e ligjit penal ka theksuar se rrethanat faktike, pra veprime e palëve ndërgjygjse të provuara përmes procesit gjyqësor janë veprime të cilat nuk e përbejnë figurën ligjore në kuadër të se cilës gjykata i ka gjetur fajtor të akuzuarit pasi që të provuarit e procesit penal ka provuar rrethana faktike jo identike me figurën e veprës penale përkatësisht elementet e saj pasi që rrethanat faktike si në vijim nuk mund të subsimohen në kuadër të institutit të lartë cituar për faktin se nuk e kanë identitetin e njëjtë. Sipas mbrojtjes shkelja e ligjit penal ekziston se nga provat e administruara janë vërtetuar faktet se të akuzuarit nuk e kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar dhe në vijim i referohet provave që konsideron se kanë rezultuar me të provuarit e fakteve; së A.B se bashku me R.Sh me dt...., kanë bërë njoftim në formë të shkruar të gjithë personave të cilët kanë qenë duke e shfrytëzuar pronën e tyre pa autorizim, parashtrimi i njoftimit është bërë nga pronaret faktit të palujtshëmrisë lëndore dhe se lidhur me këtë të njëjtit kanë poseduar të drejtat e tyre sendore, ndërsa pas pranimit të njoftimit është provuar fakti se i dëmtuari M.T është personi që ka kërkuar përmes ndërmjetësueseve për të kontaktua me pronaret e palujtshëmrisë dhe se si i njëjti përmes S.B dhe mikut të tij N.I është venë në kontakt me R.Sh. dhe A.B, dhe në bazë të dëshmive të të dëmtuarit është jo kontestuese fakti se i njëjti për ka kërkuar nga të akuzuarit të hyje në mardhenjë kontraktuale që objektin ta mban me qira, i dëmtuari M dhe tani i ndjeri R.Sh në prani të ndërmjetësueseve S.B dhe N.I janë takuar në Durrës të Shqipërisë dhe janë dakorduar lidhur me shfrytëzimin e sipërfaqes prej 1 h, ashtu që kjo marrëveshje është formalizuar dhe e njëjta është nënshkruar në vitin 2012 në mes të A.B në cilësinë e dhënësit të qirasë dhe M. T në cilësinë e marrësit të qirasë, mirëpo duke ju referuar marrëveshjes se formalizuar është vërtetuar se i dëmtuari nuk e ka paguar qiranë për hapësirën e tokës ku ka qenë duke e shfrytëzuar dhe vazhdon ende....., duke vazhduar me teje me elaburimin e provave dhe rretheve të cilat konsideron se janë vërtetuara mbrojtja thekson se gjatë gjithë procedurës është provuar fakti se A.B dhe tani i ndjeri R.Sh janë pronar faktik të palujtshëmrisë lëndore dhe të cilët kanë vepruar në bazë të autorizimeve ligjore dhe të drejtave sendore kur kanë parashtruar kërkesat për lirim e pronës së tyre dhe kjo e drejtë mbështet në të drejtën materiale ligji Nr.2004/32 neni 50. Lidhur me rrethanat e vërtetuara mbrojtja ka shtuar se nga të dëmtuarit M dhe K.T dhe dëshmitari N.I është vërtetuar se lartësi e ofertës se dhënë ka qenë .. mij euro ndërsa marrëveshja është arrit për .. mij euro, pastaj M. T ka deklaruar së në D...të Sh... ka shkuar me bashkëshorten e tij dhe mikun e tij, dhe nga faktet e deklaruar nga i dëmtuari rezulton se nuk kanë ekzistuar veprimet kundërligjore dhe se viktima e pretenduar nuk ka pasur frikë kundrejt agresorit, andaj nga gjendja faktike e provuar si me larë nuk është provuar se veprimet e të akuzuarve janë identike me përcaktueshmërinë ligjore të veprës penale të detyrimit ashtu që si



rrjedhje e vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, në mungesë të elementeve qenësorë të veprës penale të detyrimit është shkelur ligji penal në dëm të të akuzuarve, për faktin se në kuptim të faktit juridik vepra penale e detyrimit qëndron në detyrimin e tjetrit me forcë apo kanosje serioze që të veproj apo të mos veproj, pastaj vepra penale detyrimi qëndron në detyrim e tjetrit me forcë, përdorimin e kanosjes serioze që të veproj ose mos veproj....., ashtu që në kuptim të rrethanave qartësisht është provuar se nuk është plotësuar elementi qenësor i veprës penale të detyrimit, ndaj gjykata gabimisht ka gjetur se veprimet e të akuzuarve përbejnë vepra penale, pasi që veprimet e ndërgjyqeseve janë vërtetuar se janë raporte juridiko civile.

Lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mbrojtja i referohet përfundimeve të gjykatës dhe thekson se gjendja faktike nuk është në harmoni me provat materiale dhe personale si dhe faktet objekt i shqyrtimit gjyqësor, ndërsa përfundimet e shkallës së parë se i akuzuari A.B ka lëshuar me qira objektin në periudhën kohore ... deri në mars të vitit .... janë pretendime të gabuara pasi që objekt kontraktual ka qenë sipërfaqja e tokës prej një hektari, pra nuk është i drejtë përfundimi pasi që objekte i saj kanë qenë lokalet, gjithashtu përfundimi gjykatës së të akuzuarit kanë pasur qëllim të përfitimit të kundër ligjor është përfundim jo i drejtë pasi që të akuzuarit A.B dhe tani i ndjeri R.Sh janë personat përfitues e në rastin e të njëjtëve nuk mund të konstituohet fakti se kanë përfituar në mënyrë të kundërligjshme pasi që përfitimi për secilin ka bazë ligjore në kuptim të faktit se janë pronar me të drejta poseduese të palujtshëmrisë dhe këtë fakt e kanë provuar provat materiale. Përfundimet e gjykatës se M.T dhe K.T janë detyruar në ndërmarrjen e veprimeve kundër vullnetit të tyre janë përfundime të gabuara pasi që rrethanat faktike kanë vërtetuar se ecuria e veprimeve të ndërgjyqeseve nuk ka identitet të njëjtë me figurën e veprës penale ngas epo qe se i referohemi përmbajtjes se njoftimit nuk është evidentuar emri i tyre ndërsa të njëjtit përmes dëshmimeve të tyre kanë vërtetuar faktin se kanë kërkuar ndërmjetësues për të kontaktuar me Arbenin dhe tani të ndjerin R, dhe me këtë fakte me çfarë rrethanë është vërtetuar detyrimi, kurse të akuzuarit A dhe tani i ndjeri R të gjitha veprimet i kanë bërë në bazë të se drejtë së pronësisë mbi tokën, në përmbajtje si me lartë e njëjta ka objekt kontraktual qira mbajtjen e sipërfaqes prej 1 hektarë. Tutej mbrojtja ka shtuar se ka qenë detyrim nënshkrimi i marrëveshjes të datës 05.06.2021, atëherë pse të njëjtit nuk e kanë denoncuar detyrimin pasi që procesi penal ndaj të akuzuarve ka fillor në vitin 2015 ashtu që të dëmtuarit gjatë kësaj kohe kam pasur mundësi denoncimi, prandaj është e pa kuptim që përgjegjësia penale e të akuzuarve të mbështet në deklaratimet e të dëmtuarve dhe lidhur me këtë i referohet deklaratimi të të dëmtuarit M.T i cili në pyetjen e mbrojtjes në procesin e dt....., se a janë të sakta deklaratimet e tuaj në polici dhe prokurori i njëjti

është përgjigjur se qëndroj pran atyre deklaratave që sipas mbrojtës nuk janë të sakta pasi që ky fillimisht thekson grupa e R.Sh, pastaj në prokurori grupa e A.B, ndërsa gjatë shqyrtimit gjyqësor nxjerr përfundime të pa emëruara e pastaj deklaroi se po e lajm e A.B, prandaj fshehja e se vërtetës nga ky dëshmitarë jo i sigurtë është vërtetuar në polici kur ka mohuar faktin se ky ka kërkuar ndërmjetësim, po ashtu në deklarin e tij deri në shqyrtimin gjyqësor asnjëherë nuk ka qenë konsistente, ndërsa dëshmitari K.T është sublimuar si palë e dëmtua, bazuar në rrethanat faktike është e pa kuptueshme se për çka është dëmtuar ky person. Gjykata në rezultatin përfundimtarë në mënyrë jo të drejtë ia ka falur besimin deklarinimeve të këtij dëshmitari e cila edhe është prova kryesore i cili me përshkrimin e ngjarjeve imagjinare jo reale, janë mundur që të i japin konetacion figurës së veprës penale, mirëpo provat kryesore vërtetojnë se ky dëshmitar është i pa besueshëm, dhe gjithashtu ky dëshmitar përshkruan lartësi të ndryshme të investimeve rrethana faktike jo identike me dëshminë e babait të tij dhe provat kryesore. Po ashtu ky dëshmitar ka gënjer kur është pyetur nga mbrojtja se a ka pas kontakte telefonike me të pandehurit A dhe S, I njëjti e ka pohuar këtë, kurse provat e përgjimeve e demantojnë këtë, prandaj mbrojtja nuk mund të e pranojë një përfundim të tillë, pasi që deklarinimet e dëshmitarit janë të ndryshueshme e jo kredibile.

Me tutje gjithashtu i referohet përfundimeve të gjykatës në kuptim të parimit të means rea, pra mendja kriminale, mirëpo tërësia e procesit penal ka nxjerrë fakte në kuptim të çështjes lëndore pra qenë nga viti 2004, jashtë objektit të akuzës pasi që tani i ndjeri R Shairi është vërtetuar se në vitin 2004 të drejtën e pronësisë e ka fituar me mirë besim edhe përmes bazës juridike të drejtën e posedimit, është kontestuar nga palët pa legjitimet, ndërsa deri sa këta persona e kanë fituar të drejtën e pronësisë edhe në aspektin formal siç përcakton ligji, në vitin 2012 kur edhe kanë shkuar për të bërë matje në paluajtshmerinë siç e kanë lënë edhe njoftimet, nuk kanë kërkuar nga askush lirin e pronësisë e as pagesën në emër të qirasë apo forma të detyrueshme dhe kjo teori e mbrojtës është vërtetuar në proces penal, andaj kjo gjendje reale nuk përkon me mendjen kriminale, por me mendjen bazuar në frymën ligjore. Përveç kësaj gjykata ka nxjerr përfundime të pa drejta edhe sa i përket dëshmisë së dëshmitarit D.M, kur ka konstatuar se i njëjti ka potencuar se A.B me disa persona të tjerë i kanë thënë babait të tij se nuk ke tok dhe duhesh me hek dor nga ajo tok, dhe se në do ta kthejmë në mënyrë legale, pasi që ky konstatim është jo i drejtë, pasi që dëshmia e këtij dëshmitari është në kuptim të disa personave të tjerë që është vërtetuar se i kanë bërë presion pronarit të tokës me e mohu të drejtën e tij me qëllim që të e dëmtoj pronarët aktual.

Lidhur me sanksionin penal, thekson është jo kontestues fakti se pronari i paluajtshmërisë A.B është dënuar për detyrim në kuptim të subjektivit pasiv si posedues jo pronar i pronës së të dënuarit, po ashtu A.B e ka bërë me vetëdije se ka të drejtë që ta përdor edhe të përfitoj nga prona e tij, ashtu që ka kërkuar lirimin e saj, ndërsa me kërkesën e poseduesit prona ka hyr në marrëdhënie kontraktuale për qirambatjtje dhe kjo është gjendja faktike. Gjykata sa i përket vendosjes së lartësisë dhe llojin e dënimit nuk i ka marr parasysh rrethanat faktike, nuk i ka vlerësuar drejtë të drejtat subjektive të akuzuarit A.B, sepse në kuptim të këtyre të drejtave i akuzuari është gjendur në lajthim faktik, ndonëse mungon kundërligjshmëria. Në elementet subjektive A.B, në asnjë rrethanë nuk mund të vërtetohet fakti se ka pas pretendime të kundërligjshme të gjitha veprimet janë derivativë e perceptimit mendor se është pronar i sendit të paluajtshme dhe ka të drejtë që ta posedoj, për më tepër gjykata nuk i ka vlerësuar rrethanat lehtësues ashtu që lartësia e dënimit është në shpërputhje me rrethanat faktike, andaj në vlerësimin e çështjes lëndore në rastin e konstatimi si të drejtë dhe të ligjshëm aktgjykimin i atakuar të vlerësohet ligjshmëria e vendimit mbi sanksionin i cili vendim është jo i drejtë për shkak të lartësisë së dënimit, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

Në ankesë mbrojtësja e të akuzuarit O.B av.Blerina Kurtaj në lidhje me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike thekson se gjendja faktike është në kundërshtim me provat personale dhe materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor, në të cilin janë përshkruar vetëm raportet juridiko-civile midis palëve e në asnjë rrethen elementet e veprës penale të detyrimit. Lidhur me këtë gjykata në asnjë pik të arsytimit nuk ka përmendur se ma çfarë veprime i akuzuari e ka detyruar të dëmtuarin të veproj në dëm të pasurisë se tyre duke qenë se i njëjti ka vepruar konform autorizimit të noterizuar nga pronari legjitim i ngastrës 1536 dhe i njëjti me asnjë veprim inkriminues nuk e ka detyruar askënd që të veproj në dëm të pasurisë së tij, andaj nëse pretendohet në kërcenim të rendë atëherë cilat veprime të të akuzuarit ka arritur ti vërtetoj gjykata, me saksish cilat janë fjalët, veprimet, ngase sipas aktgjykim e tërë ngjarja është e lidhur me të ndjerin R.Sh dhe në asnjë mënyrë të atë akuzuarin i cili ka qenë i autorizuar nga pronari Xh.B si pronar i ngastrës kadastrale .... dhe gjithë veprimtaria e tij është e lidhur me autorizim e punëdhënësit të tij. Sipas mbrojtës gjykata e shkallës së parë për kundër provova të admiruara gjatë shqyrtim gjyqësor dhe dëgjimit të dëshmitarëve nuk ka mundur të vërtetoj përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari e ka kryer veprën penale detyrimi, ndërsa deklaratave të dëshmitarëve M dhe K.T nuk është dashur që t'ia fal besimin për faktin se të njëjti janë familjar mes veti respektivisht babë e djalë dhe është e natyrshme që këta persona të dëshmojnë në anën e njëri tjetrit për kundër faktit se deklaratimet e tyre gjatë gjithë procesit kanë qenë kontradiktore,

ku ndër të tjera i dëmtuari M.T gjatë shqyrtimit gjyqësor fjalën marrëveshje e ka zëvendësuar me fjalën detyrim duke mos qëndruar në deklarinimin e tij mbi bazën e se cilës është ngritur kjo aktakuzë, tutje lidhur me këtë dëshmitarë mbrojtja i referohet deklarinimit të tij në prokurori dhe në shqyrtimin gjyqësor dhe nga këto deklarime rezulton se i njëjti ka qenë i pasaktë duke hedhur hipoteza pa asnjë bazë të vetme, vetëm për ta ngarkuar të akuzuarin duke shtuar se, “sipas sjellëve të qirangjinjeve që kanë qenë të gatshëm ta lirojnë objektin ata thojnë së kemi marrëveshje me O. B dhe nuk e njehim askënd tjetër sepse nuk ka kurrfarë bazë ligjore në objektet e mija, “, pastaj të akuzuarit dhe i ndjeri R gjatë periudhës ... kanë ardhur vazhdimisht pran objekteve në mënyrë të organizuar të armatosur, gjithherë na kanë kërcënuar dhe kanë urdhëruar të largohemi nga objekti....., duke cek pjesë të caktuar të deklaratave të të dëmtuarit të dhëna në prokurori dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të dt..... të cila deklarime sipas mbrojtjes janë kontradiktore, jo kredibile dhe të pa bazuara andaj nuk është dashur ti falet besimi. Prandaj nga këto deklarime gjykata e shkallës së parë lidhur me përshkrimet e verimeve të akuzuari nuk ka mundur ta mbështes dyshimin e bazuar mirë apo të vërtetoj përtej dyshimit të bazuar se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën është dënuar, pasi që gjykata me përfundimet e saj nuk ka arrit që saksish të definoj veprimet konkrete të të akuzuarit se çka saksish i ka detyruar të dëmtuarit të marrin veprime në dëm të pasurisë së tyre, duke mos cekur asnjë veprim konkret dhe të argumentuar me prova as materiale përgjimeve të bisedave e as dëgjimit të dëshmitareve, ku asnjëri me saktësi nuk ka arrit të argumentoj se me çfarë veprime-konkrete serioze i paska detyruar këta persona të veprojnë në dëm të pasurisë së tij. Ka shtuar se nga arsyetimi i aktgjykim rrjedh se gjykata i ka falur në tersi besim edhe të dëmtuarit H.Sh, mirëpo nga deklarimi e këtij dëshmitari nuk mund të provohet se i akuzuar ka kryer veprën penale, pasi që deklarinimet e tij nuk përkojnë në gjendjen faktike të përshkruar në aktakuze pasi që i njëjti në shqyrtimin gjyqësor është përgjigjur se për mua nuk ka pasur kërcënime direkte por për qirangjinjet po, kanë shkruar letra se duhet me i liru objektet dhe për mu ky ka qenë kërcënim, ndërsa lidhur me pyetjen se a keni pasur kontakt ndonjëherë me telefon me O.B i njëjti përgjigjet se nuk ka pasur asnjë kontakt, bazuar në këtë si është e mundur që i akuzuari të të akuzohet me veprën penale të detyrimit dhe në çfarë forme është dëmtuar ky person apo perse e ka cilësinë të dëmtuarit kur asnjë deklarim i tij nuk përkon me veprimet inkriminuese të të akuzuarit, po ashtu edhe lidhur me këtë dëshmitarë mbrojtja i referohet deklarinimit të tij në shqyrtimin gjyqësor se çka në fakte i njëjti ka deklaruar duke përfshirë këtu edhe pyetjet që i janë bërë nga anëtarët e trupit gjykues lidhur me atë se çka konsideron detyrim.

Ndërsa sa i përket provave materiale konkretisht masave të fshehta të përgjimit të telekomunikimeve me asnjë provë as në mënyrë direkte e as indirekte nuk mund të vërtetohet veprimi i të akuzuarit në drejtim të veprës penale për të cilën është dënuar. Përfundimisht mbrojtja konsideron se dispozitivi i aktakuzës është marrë me përshkrimin e komunikimeve të palëve që si të tilla kanë qenë të natyrës juridiko civile e aspak të veprës penale e cila është objekt i akuzës, prandaj nga kjo rezulton se me asnjë provë qoftë materiale apo personale gjykata nuk ka mundur të vërtetoj faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë por i njëjti ka qenë i autorizuar nga pronari legjitim i ngastrës kadastrale ... dhe vetën e ka kryer punën e tij sipas autorizimit të noterizar, pa asnjë kërcenim dhunë apo kanosje ndaj askujt, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

Në ankesë i akuzuari S.B thekson se konstatimi i gjendjes faktike si në aktgjykimin e ankimuar është i gabuar dhe jo i plotë për faktin se nga dëshmitë e dëshmitarëve, fakteve dhe provave tjera të vërtetuara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i njëjti në asnjë rrethanë nuk kam ndërmarrë asnjë veprim në raport me të dëmtuarin, gjithashtu është vërtetuar se asnjëherë nuk ka pasur kontakte telefonike me të dëmtuarin edhe për kundër faktit se i dëmtuari ka dhënë dëshmi të rreme, mirëpo kjo vërtetohet përmes traskripteve telefonike. Ka shtuar se i janë konfiskuar parat që i ka pranuar nga familjaret e bashkëshortes si ndihme për hapjen e biznesit të bashkëshortes, ku në shkresat e lëndës janë të gjitha provat që vërtetojnë prejardhjen e mjeteve monetare. Prandaj falja e besimit dëshmive të dëmtuarave nga gjykata, në mungesë të provave kryesore apo fakteve tjera është përfundim i gabuar, sepse dëshmitari M. T, në pyetjen time është përgjigjur se asnjëherë nuk kam dhënë para ty, ndërsa në pyetjen se a ke prova se je takuar ndonjëherë me mua i njëjti është përgjigjur se jo, duke pas parasysh gjendjen faktike si në dispozitiv është vërtetuar në proces së dëshmitarët kanë gënjyer gjatë procesit penal në të gjitha fazat, i kanë ndërruar deklaratat, dhe tërë përgjegjësin i ja kanë vënë në barrë R.Sh pas vdekjes së tij dhe A.B. Tutje ka shtuar se nga tërësia e provave materiale posaçërisht dëshmitarit N.I është vërtetuar se nuk jam përgjegjës dhe nuk kam manifestuar asnjë element të veprës penale, andaj gjykata në këtë rast ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike.

Në lidhje me shkeljen e ligjit penal i akuzuari pretendon se gjykata ka bërë shkeljen e ligjit penal në dëm të tij kur ka gjetur se është fajtor, ndërsa tërësia e fakteve të provuara në shqyrtim gjyqësor kanë provuar të kundërtën se nuk kam ndërmarr veprim e as që kamë lidhje kauzale me të dëmtuarit, andaj në mungesë të elementeve qenësore të figurës ligjore të veprës penale për të cilin është shpallur fajtor, paraqet shkelje të ligjit penale në mungesë të veprimeve të kundërligjshëm, andaj propozon si me lartë.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.B, av.Illir Hoxhaj në përgjigje në ankesën e Prokurorisë Speciale ka theksuar se cilësia e fakteve mbi të cilat mbështetet akuza kanë cilësinë e fakteve jo kredibile e të pabesuara, për me tepër Res Judicata, pasi që nga provat e administruara është vërtetuar gjendje tjetër faktike nga ajo që është pretenduar nga prokuroria konkretisht në faqen 4 të aktakuzës dhe i referohet kësaj pjese. Sipas mbrojtjes tërësia e parashtrimeve të prokurorisë është në kundërshtim me parimin in dubie pro reo, është e qartë siguria juridike e ndërtuar në këtë institut, askush nuk mund të konsiderohet si përgjegjës apo i fajshëm për një vepër penale për të cilën nuk ka aktgjykim të formës së prerë, ndërsa prokurori thirret në raste të cilat kanë përfunduar në favor të akuzuarit A.B. Prokuroria qartësisht ka tendencë që faktin jo identik me elemente përbërëse të figurës ligjore të detyrimit ta subsimoi në kuadër të institutit para cituar dhe e tërë kjo tendencë është rezultat i mungesës së provave kredibile dhe me fuqi ligjore për të vërtetuar përgjegjësin dhe kundërligjshmërinë e të akuzuarve në kuptim të veprës penale, ku në këtë kuptim janë bërë shkelje ligjore në dëm të akuzuarve. Ka shtuar se përshkrimi narrativ është standardi i prokurorisë, ku në faqen 3 të ankesës përshkruan faktin mbi çështjen juridiko kontestimore të ish shtetasit M.M. Në procedure provuese është administruar si provë Aktvendimi i Gjykatës Komunal në Prishtinë C.nr....., ku është vërtetuar se shkesat e lëndës me këtë numër, subjekt i asaj procedure ka qenë paditësi M.M dhe e paditura ndërmarrja “...në bazë të shenjës siç përmban edhe ky aktvendimi janë ri-përtëritës në përputhshmëri me standarde procedurale juridike të karakterit civil si instituti i paraparë në bazë të nenit 116 lidhur me 117 të Rregullores mbi Veprimtarin e Brendshme të Gjykatës e cila ka qenë në fuqi në kohën e ecurisë procedurale, është vërtetuar fakti se pretendimet e prokurorisë për mos ekzistencën e shkresave civile, përfshirë edhe aktgjykimin civil nën shenjën si më lartë janë jo ekzistente dhe të pabazuara. Po ashtu tërësia e fakteve dhe parashtrimeve në referatin e ankesës nga prokuroria kanë cilësinë e fakteve dhe pretendimeve jo kauzale me objektin e aktakuzës, është e habitshme se si institucioni kushtetues mohon qartësisht faktin notor, kjo qasje e prokurorisë për mbrojtjen është shqetësim i jashtëzakonshëm, si dhe nuk është vërtetuar asnjëri nga pretendimet e prokurorisë dhe kjo prokurori ka cenuar ligjshmërinë, andaj nga të gjitha këto rrethana propozon si më lartë.

### **Vlerësimi i Gjykatës së Apelit**

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore nuk qëndrojnë e as që ka shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale, për të cilat, sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar për faktin se në

dispozitivin e aktgjykimit janë përshkuar në tersi veprimet inkriminuese e të akuzuarve të cilët formojnë elementet e veprës penale për të cilin janë shpallur fajtor dhe si i tillë është i qartë dhe i kuptueshëm ndërsa në arsyetim janë dhënë arsye të qarta dhe të plota për çdo pikë të aktgjykimit për faktet vendimtare ashtu edhe për zgjidhjen e çështjeve juridike të kësaj çështje penale.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me këto prova ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive, të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë pasi që vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitat e nenit 361 par.1 të KPPRK-së, duke dhënë arsye të qarta për vendimin, kohën dhe mënyrën se si ka ardhur deri të kryerja e veprës penale nga të akuzuarit, kjo pasi që nga dëshmitaret, konkretisht i dëmtuari M.T, pa kontestueshëm është vërtetuar fakti se i njëjti pasi që kishte lidhë kontratë për qiranë e cila figuron në emër të tij, i njëjti ishte partner në këtë tokë së bashku me H.Sh dhe I.O dhe me qëllim të funksionalizimit të tokës për qëllime afariste në këtë tokë të marrë me qira janë ndërtuar disa objekte dhe janë investuar shuma të konsiderueshme nga që të tre të dëmtuarit, ku me pastaj të njëjtat objekte janë lëshuar me qira, dhe një pjese të saj ka operuar biznesi i të dëmtuarit M.T i quajtur “...”. Kjo rrethanë se në tokën e marrë me qira dhe se janë ndërtuar objekte për qëllime afariste nuk është mohuar as nga të akuzuarit, po ashtu këtë rrethanë e kanë pohuar edhe dëshmitarët të cilat kanë marrë në shfrytëzim me qira këto objekte. Nga kjo dëshmi e të dëmtuarit M është vërtetuar edhe fakti se shfrytëzimin e papenguar të pronës e ka gëzuar deri në vitin 2004, ndërsa prej kësaj kohe janë shfaqur disa pengesa indirekte nga i akuzuari A.B bashke me S dhe O.B si dhe tani i ndjeri R.Sh, më tej nga kjo dëshmi është vërtetuar fakti se në vitin 2004 nga drejtori i “B...”, Z. K, ka kuptuar se toka ka kaluar në emër të personit M.M, ku nga përfaqësuesit e “Bujqësia “, si dhe nga dëshmia e të dëmtuarit M është vërtetuar fakti se nga viti ..... ka qenë një periudhë relativisht e qetë edhe pse A.B kohë pas kohe është paraqitur tek prona në fjalë, dhe diku nga shtatori ..., janë paraqitur të pandehurit së bashku me tani të ndjerin R.Sh, pra, gjykata e shkallës së parë ka bërë analizën e të gjitha provave të procedura gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur përfundimet, të cilat si të drejta objektive, dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendim ankimor të PSRK-së, përkitazi me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.7 të KPPRK-së, ku gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë asnjë vendim lidhur me kërkesën e prokurorisë që të anulohen të gjitha veprimet juridike të ndërmarra sipas dokumenteve të falsifikuara edhe pse ka pasur prova të mjaftueshme dhe bazuar në këtë Gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar sipas nenit 370

par.6 dhe 7 pasi nuk paraqiti arsye për çdo pikë të aktgjykimit dhe se në rastin konkretë gjykata është koncentruar vetëm në elementet e veprës penale të Detyrimit dhe tërësisht i ka shpërfillur një seri të veprimeve sekondare, kundërligjore të akuzuarve, të cilat të njëjtit i kanë ndërmarr me qëllim që ta përvetësojnë tokën në fjalë.

Gjykata e Apelit pajtohet me përfundimin dhe qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm e të arsyetuar në mënyrë të qartë dhe të plotë në aktgjykimin e ankimuar, si në fq.49, se për çfarë arsye të dëmtuarën AKP-ën e kishte udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, kjo pasi që ndërmjet aktakuzës dhe aktgjykimit duhet të ekzistoj identiteti subjektiv dhe objektiv bazuar në nenin 360 të KPPRK-së, ngase aktakuza e PSKR-së të akuzuarit i kishte ngarkuar për veprën penale bazë të Detyrimit nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK-së, figura e të cilës përbehet nga elementet të cilat janë përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar ndërsa në anën tjetër gjykata në këtë çështje penale nuk ka pasur akuzë edhe për veprë penale, si pretendon në ankesë, të falsifikimit apo legalizimit të përmbajtjes së pavërtetë që në kuadër të kërkesës pasurore – juridike do të mund të anulonte veprim juridik që lidhet me të drejtat pronësore në raport me veprat penale.

Për më tepër një obligim ligjor i anulimit të veprimeve juridike do të ekzistonte nëse të akuzuarit do të gjendeshin fajtor për veprën penale që kishte për të pasur pasojën që ndërlidhen me veprimin juridik për të drejtat pronësore por jo si në këtë çështje penale ku prokuroria të akuzuarit nga përshkrimi faktik rezulton se i ngarkon për veprimet e përdorimit të forcës dhe kanosjes serioze ndaj të dëmtuarve M e K.T me qëllim të njëjti ti detyrojnë që të veprojnë në dëm të pasurisë së vet.

Përkitazi me këtë pretendim Prokuroria në përshkrim faktik të dispozitivit të aktakuzës, për këtë fakt konstaton se, lidhur me çështjen e legalizimit të përmbajtjes së pavërtetë në raport me këtë aktgjykim të falsifikuar, fq.4, më datë ... Janar ..., personi i cekur më lartë-M.M në rastin P.nr.2081/10 përfundimisht është liruar nga përgjegjësia penale për veprën penale Legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë, pra është e qartë se të akuzuarit në këtë çështje penale nuk ishin të akuzuar për veprat tjera penale si pretendon me ankesë prokuroria por vetëm për veprën penale bazë, të Detyrimit nga neni 267 par.2 të KPK-së, si edhe arsyetën gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar.



Në anën tjetër për sa i përket pretendimeve ankimore të Prokurorisë së gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar, si në faqen 35 të aktgjykimit, numëron provat të cilat vërtetojnë faktin se kalimi i pronësisë nga shoqërore në atë private është kryer në bazë të dokumentit të falsifikuar, kolegji i kësaj gjykate gjen se ky pretendim është i pabazuar ngase nga këto provat rezulton të jenë vërtetuar faktet në drejtim të veprimeve të ndërmarra nga të akuzuarit në raport me pronësinë-objektet e ngritur nga të dëmtuarit në këtë parcelë të marrë me qira dhe jo se me këto provat do të mundë të shpallin fajtor të akuzuarit për veprat tjera penale ngase, ashtu si është theksuar edhe më lartë, në këtë çështje penale të akuzuarit nuk janë akuzuar edhe për veprat tjera penale bazë, përpos vepër bazë penale të Detyrimit nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK-së të ndërlidhur me veprën penale të Krimit të Organizuar nga neni .

Kolegji penal i kësaj Gjykate gjen të pabazuar pretendimin ankimor se dispozitivi i aktgjykimit në mënyrë drastike është shkurtuar, i privuar nga shumë fakte të vërtetuar të cilat kanë ndikuar në marrjen e aktgjykimit në kundërshtim me provat dhe se dispozitivi i aktgjykimit fillon nga viti 2012, duke anashkaluar plot 8 vite gjatë të cilave ky grup i organizuar kriminalë ka kryer shumë vepra të ndryshme penale të cilat edhe vetë gjykata i përmend në arsyetim.

Fillimisht kolegji penale i kësaj gjykate rikujton se, ashtu si është konstatuar edhe më lartë, në këtë çështje penale gjykata e shkallë së parë ka vepruar konform obligimit ligjor të nenit 360 të KPPKR-së, ku ka dhënë arsyet të qarta se ndërmjet aktgjykimit të ankimuar dhe aktakuzës duhet të ekziston identitet subjektiv dhe objektiv, ngase aktakuza e PSKR-së të akuzuarit i kishte ngarkuar për veprën penale bazë të Detyrimit nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK-së, edhe pse këtë vepër penale e ka ndërlidhur me veprën penale të Krimit të Organizuar nga neni 274 të KPK-së, për të cilën kjo gjykata do ti referohet në vijim të arsyetimit lidhur me vlerësimin e mos vërtetimit të ekzistimit të elementeve të kësaj vepre penale.

Në anën tjetër, fakti i pretendimit të prokurorisë për anashkalim të 8 viteve nga dispozitivi i aktakuzës është një pretendim i pabazuar pasi që gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara ka vërtetuar gjendjen faktike duke precizuar në këtë mënyrë periudhën kohore kur të akuzuarit kishin ndërmarrë veprime inkriminuese për veprën penale të Detyrimit nga neni 267 par.2 të KPK-së, për të cilën janë akuzuar dhe shpallur fajtor të akuzuarit dhe jo kohën kur aktakuza pretendon se të akuzuarit kanë kryer vepra të ndryshme penale, ngase ashtu si është theksuar edhe më lartë rrjedh se prokuroria me aktakuzë nuk i ka akuzuarit të akuzuarit për veprat

tjera penale pos për veprën penale bazë, të Detyrimit nga neni 267 par.2 të KPK-së, të ndërlidhur me veprën penale të Krimin të Organizuar nga neni 274 të KPK-së.

### Të gjeturat lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike

Sa i përket pretendimeve ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë edhe gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për faktin se me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit A.B, O.B dhe S.B janë kryes të veprës penale për të cilën janë shpallur fajtor.

Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se të akuzuarit A.B, O.B dhe S.B në mënyrën e përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, kanë kryer veprën penale të Detyrimit nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK-së, për faktin se nga data 24.05.2012 në vazhdimësi deri mars të vitit .... në P..., në F.K dhe në D.. të R. së Sh..., të pandehurit A.B, O dhe S B, së bashku me tani të ndjerin R.Sh, duke vepruar në grup, me dashje e me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, duke përdor kanosje serioze ndaj të dëmtuarit M dhe K.T, duke i mbajtur nën përcjellje dhe vëzhgim të vazhdueshëm si dhe duke ju drejtuar personalisht me fjalët “ose i pranon këto kushte ose ke probleme të mëdha me neve”, si dhe përmes ndërmjetësve me fjalët si” kemi me të likuidua së bashku me familjen dhe shpien kemi me ta marr”, “deri nesër me na pru .... euro përndryshe mos llogarit që ke djalë, as familje, as shtëpi”, i kanë detyruar të njëjtit që të veprojnë në dëm të pasurisë së tyre të cilat gjenden në palujtshmerinë – ngastrën kadastrale numër ... në sipërfaqe prej 1 hektari në F.K, rruga për P...të cilin i dëmtuari M me datë ... e ka marr në shfrytëzim për 10 vite sipas kontratës me pronarin legjitim K..., ndërmarrja shoqërore “B..”, dhe në të cilin të dëmtuarit i kanë ndërtuar 4(katër) objekte në vlerë të përgjithshme më shumë .... euro, në atë mënyrë që me datë ... në objektet e të dëmtuarit M.T janë paraqitur të pandehurit dhe tani i ndjeri R.Sh, të cilët kanë kërkuar që në afatin sa më të shkurtër të i lirojnë objektet, ndërsa në të gjitha bizneset e kanë lënë edhe nga një shkrese me mbi shkrimin “njoftim” me përmbajtje “uzurpatorët urgjentisht ta lirojnë pronën”, për shkak të ndryshimit të pronarit të tokës dhe në këtë njoftim ka qenë i shënuar numri i telefonit të pandehurit A.B dhe nënshkrimi i tij, si dhe të akuzuarit rregullisht kanë qëndruar në afërsi të pronës duke bërë presion psikik te të dëmtuarit në atë mënyrë që ju kanë drejtuar me ultimatum që ti lirojnë objektet ose në të kundërtën do të vije deri te më e keqja,

ndërsa nën presion dhe kanosje të vazhdueshme disa ditë më vonë në Durrës të Shqipërisë me ndërmjetësimin e dëshmitareve N.I dhe S. B, e kanë detyruar të dëmtuarit M.T që të bëjë marrëveshje në dëm të pasurisë së tij duke i kufizuar maksimalisht zotërimin mbi objektet e tij, ashtu që kanë detyruar që çdo muaj ti jep shumën e qirasë prej 6350 € (gjashtë mijë e treqind e pesëdhjetë euro), dhe e kanë kufizuar në shfrytëzimin e vetëm njërit prej objekteve të tij për biznesin e tyre familjar "...". Ndërsa nga muaji Qershor – Korrik ... A.B pa pëlqimin e pronarit ka lëshuar me qira edhe një objekt tjetër po ashtu pronë e të dëmtuarit M.T në shumën prej 3000 € (tremijë euro), më pastaj në Dhjetor vitit 2... i pandehuri A.B në marrëveshje dhe me kërkesën e R.Sh, të dëmtuarit M i ka kërkuar që të paguaj shumën prej .... € (dhjet mijë euro) shtesë në atë mënyrë që ka shkuar në shtëpinë e të dëmtuarit M duke i drejtuar kanosje serioze "deri nesër me na pru 10.000 euro përndryshe mos llogarit që ke djalë, as familje, as shtëpi", por i dëmtuari nuk ka arrit me mbledh në tërësi shumën e kërkuar, ashtu që disa ditë më vonë djali i tij, i dëmtuari K.T, në restorantin "C..." ja ka dorëzuar tani të ndjerit R.Sh shumën prej ... € (...). Në Mars të vitit 2014 të pandehurit përmes telefonit e kontaktojnë dhe i kërkojnë të dëmtuarin K.T që të takohet në restorantin "C..." duke e kërcënuar se nëse vjen me babin do ta vrasim ku të njëjtin e ka pritur i pandehuri A.B, O.B, S.B dhe R.Sh si dhe duke i drejtuar kanosje serioze me fjalët "nëse nuk e lëshoni objektin për dy javë M dhe anëtarët e tjerë të familjes i keni të vrarë", e pastaj e kanë detyruar të njëjtin që të hyj në veturën e tyre e kanë dërguar te qiraxhinjtë e lokaleve dhe e kanë detyruar që të njëjtëve të ju tregoj se tani e tutje qiratë do të ja paguajnë të pandehurve, ashtu që nga kjo kohë të dëmtuarve M.T dhe K.T të pandehurit ja kanë ndaluar edhe qasjen fizike në objektet e tyre, ku të njëjtit ishin detyruar që ta tërheqin mallin nga aty dhe ta deponojnë në një depo të hapur ku edhe kishin pësuar humbje të konsiderueshme materiale si pasojë e mos magazinimit të rregullt, ndërsa të pandehurit kanë vazhduar që të disponojnë në tërësi me pronën ashtu që fitimin nga qiramarrësit Besnik Krasniqi, Xh.P, N. Ll., si dhe fitimi nga lëshimi me qira i lokaleve nga qiramarrësit e rinjë A. H, J. V, B. K, të pandehurit e kanë ndarë mes veti, duke përfshirë edhe familjen e R.Sh.

Deri të kjo gjendje faktike, gjykata e shkallës së parë kishte ardhur pas administrimit provave, siç janë; deklarata e të dëmtuarve-dëshmitarëve M T, H.Sh, A.H, I.O, deklarata e dëshmitarëve N.Ll, N.I, Xh. P, E.P, L. D, H.Sh, J, V, Sh. B, Xh.B, A.H, A.H, H. H, V. H, S. (A..) B, E.M dhe D. M, si dhe provat materiale; Raportet e bastisjes të dt. ... në shtëpitë e të pandehurve, me fotoalbumin dhe vërtetimet mbi konfiskimin e sendeve, Rezultatet e masave të fshehta të përgjimit të telekomunikimeve dhe regjistrimit të bisedave telefonike të të pandehurve – transkriptuat e bisedave, raportet e përgjimit, raporti lidhur me regjistrimin e bisedave dhe

përmbajtjeve e SMS-ve, Kontrata nr. 40/1 e dt. .... mbi dhënien e tokës me qira mes K.. NSH “B..” F. K, dhe M.T me aneksin e dt. 18 Korrik ..., Fleta poseduese nr. ... me kopjen e planit dhe fleta poseduese nr. .... sipas të cilave ngastra ..., i takon PSH “Bujqësia”, Kopja e dokumentacionit të Drejtorisë së Kadastrit në lidhje me ngastrën kadastrale ... Shkresat e K.. “B...” e dt. 23....., si dhe ankesa e dt. .... me të cilën kontestohet ndryshimi në librat kadastrale, Raporti i ekzaminimit të dëshmive – të pajisjeve të TI-së i dt. ... me raportin e ekspertizës dhe me fotoalbumin, Shkresa e M.M e drejtuar Drejtoriatit për Kadaster dhe Gjeodezi, Shkresa e Kryetarit të Gjykatës Komunale në Prishtinë lidhur me lëndën C.nr ....., Shkresa e të pandehurit A.B e dt .... me të cilën nga Drejtoria për Kadaster dhe Gjeodezi kërkon ndryshimin e pronës në operatin kadastral, Aktvendimi mbi zbatimin e ndërrimeve në operatin e kadastral i dt. 10 Mars 200, Autorizimi i falsifikuar sipas të cilit M.M e autorizon të pandehurin A.B që ti ndërmerr veprimet juridike në lidhje me pronën e tij – ngastrën kadastrale ..., Raporti i ekspertit të dokumenteve të dyshimta i dt. 03.05.2005 i përpiluar në bazë të urdhëresës së gjykatës PNH 78/05 sipas të cilit është konstatuar se kontratat e shit blerjes mes M.Mit dhe 6 blerësve janë të falsifikuara, Kontratat mbi lëshimin e lokaleve me qira, Dokumentacioni lidhur me hetimet financiare dhe rezultatet e masës së fshehtë të zbulimit të të dhënave financiare, Aktgjykimi i falsifikuar i Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr .... i dt. ...., Aktgjykimi origjinal i Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr .... dt. ...., Aktvendimi i Drejtoriatit për Kadaster dhe Gjeodezi i dt. 10 Mars 2004 për zbatimin e ndërrimeve në operatin kadastral sipas të cilit lejohet që ngastra kadastrale ... deri atëherë e evidentuar në emër të K.. Kosova Eksport NSH “...” kalon në emër të M.M, Ekstrakti nga flet posedimi nr. ....sipas të cilës kjo tokë është pronë e M.M, kontrata (gjashtë) mbi shit blerjen të: dt. .... shitës M.M blerës blerësve Xh.B, Sh.B, S.M, Xh. M, V.A, dhe M. M, Aktgjykimi refuzues i Gjykatës Komunale në Prishtinë P.nr ....., me të cilën i akuzuari M.M lirohet nga akuza për veprën penale Legalizim i përmbajtjes së pa vërtet, Deklarata e tani të ndjerit M.M e dhënë me dt ... në polici në cilësinë e dëshmitarit, Shkresa e rastit ....., Shkresat e 10 rasteve – kallëzimeve penale të paraqitura kundër të pandehurit A.B, Dokumentacioni i ATK-së lidhur me ngastrën kadastrale ..., Kontrata mbi shit blerjen e paluejtshmerise mes I.S t dhe “B....” të cilën e përfaqëson i dëmtuari A.H, Certifikata e Agjencisë Kadastrale me kopjen e planit për pronën e të dëmtuarit A.H, Dëftesa e dt ... mbi pagesën prej ... mijë euro te cilën i pandehuri A.B e ka marre nga i dëmtuari A.H, Para kontrata e dt. 14 Mars 2014 mes të dëmtuarit A. H, dhe dëshmitarit Xh.B, Aktvendimi për pushimin e hetimeve PP.nr ....., dt ..., Kontrata mbi shit blerjen e patundshmërisë e lidhur mes M..M dhe Xh.B e dt. ...., Kontrata mbi shit blerjen e patundshmërisë e lidhur mes M... Marko dhe Sh.B, e dt. ...., Kontrata mbi shit blerjen e patundshmërisë e lidhur mes M Marko dhe M.M. e dt. ...., Kontrata mbi shit blerjen e

patundshmërisë e lidhur mes M Marko dhe Gjyle Maraj e dt. 19.03.2004, Shkresa lidhur me historikun e parcelës Kadastrale me numër 1536-1 e drejtuar Xh. B, Aktvendimi për ripertrirjen e shkresave të lëndës C.nr .... i dt ..., Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr 395/96 i dt. ..., Kontrata mbi bartjen e të drejtës në shfrytëzim të patundshmërisë në kompensim e dt. 04.09.2002 lidhur në mes të KBI – NSH “B....” në F. K, dhe Aeroporti i Prishtinës, Flet posedimi me numër flet posedimi ..., Masa e përkohshme – Aktvendimi për masë të përkohshme i dt ..., Certifikata e pronësisë së bashku me kopjen e planit për parcelën – ngastrën kadastrale P-..., Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë i dt ....., Aktvendimi i lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës i dt. ...., Fleta poseduese me numër ..., Aktvendimi i dt ... me të cilën është hedhur akuza kundër të akuzuarit A.B, Njoftimi i Prokurorisë Themelore në P... i dt ....., Aktvendimi i Drejtorisë për urbanizëm, gjeodezi kadastër dhe prinë i dt ... i Komunës së F. K, Faturat që i dëmtuari M.T – pronar i F. K, pagesat i ka bërë për qira të NSH B..., Është lexuar raporti i rreshterit M. K, lidhur me bisedën e tij me dëshmitarin I.O i datës ....., Është lexuar Parashtresa e dt.... nga PSRK, me Përgjigjen e Administratorit të GJTHP-së Sh. G, të dt...., Është lexuar Zgjerimi i Kërkesës pasurore Juridike nga AKP i dt.... se bashku me Raportin e vlerësimit i dt..... të cilin e ka hartuar V. O-vlerësues i pronave të paluajtshme, Aktvendimi i Gjykatës së Apelit nën shenjën PNR.... i dt...., deklarata e ish juristit të I.O të dhënë në stacionin policor me dt....., Aktvendimi nga Prokuroria Publike e Qarkut i dt...., sipas shenjës PP.nr...., Aktvendimi i Prokurorisë Themelore në Prishtinë nën shenjën PP/II.nr.... i dt.... Aktvendimi mbi pushimin hetimeve nën shenjën P.nr.... i dt.... Njoftimi nga Prokuria Themelore në P nën shenjën PP.II.nr...., i dt.... Kërkesa e Ndërmarrjes së Bujqësia me nr. Protokolli.30 e ....., Historiati mbi origjinën pasurës lëndore i dt..., Historiati mbi origjinën e pronës lëndore i dt...., i kërkuar prej Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Çertifikata mbi të drejtat pronësore e vitit ....., Parashtresën e dt....., e parashtruar pranë ndërmarrjes G...., nga ish pronari M.M, Njoftimi e dt.16.06.2012, sipas shenjës PPN.nr...., Njoftimi e dt....., korrespondenca mes prokuroreve, konkretisht Prokurores L. P dhe Prokuroria I. B, Aktvendimi e Gjykatës Komunale në Prishtinë të dt....., Njoftimi i dt....., Marrëveshja e dt....., e lidhur në mes të A.B dhe M. T në prani të dëshmitarit N.I, Certifikata mbi të drejtat pronësore e dt...., e lëshuar nga drejtoria për Kadastër në Prishtinë, Kallëzimi penal i të akuzuarit A.B kundër prokurorit I. B i dt....., Njoftimi i dt....., Kontrata me nr.... e dt....., Është lexuar dosja nën shenjën C.nr.....

Pretendimet e prokurorisë se aktgjykimi bazohet në konkludimet e gabuara, ku disa prej provave të administruar fare nuk i ka përmendur e disa prej tyre edhe pse janë përmendur nuk janë vlerësuar, kurse pretendimet e mbrojtëseve se gjendja faktike nuk është në harmoni me provat

materiale dhe personale si dhe faktet si objekt i shqyrtimit gjyqësor, janë pretendime të pa bazuara për faktin se nga provat e administruara, deklaratat e dëshmitarëve si dhe provave materiale, gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim të drejt se të akuzuarit A.B, O.B dhe S.B kanë kryer veprën penale për të cilën janë shpallur fajtor.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimin ankimor të Prokurorisë përkitazi me pretendimin se i akuzuari Asi person bos i cili disponon me pronën e përvetësuar tregon për ekzistimin dhe qëllimin e këtij grupi, ndërsa bindja e të akuzuarve të tjerë se kanë përvetësuar tokën ka qenë e aq e fort sa që kanë bërë marrëveshjen një muaj para se toka është rexhistruar në emër të M.M dhe ky fakt dëshmon seriozitetin dhe stabilitetin e grupit, ngase ky është një prej veprimeve faktike nëpërmjet të cilët të akuzuarit kanë ardhur në pozicion për të realizuar me qëllim për të detyruar të dëmtuarit që të veprojnë në dëm të pasurisë së tyre por jo se mund të dëshmojnë çështjen e ekzistimit të veprës penale të Krimin të Organizuar ashtu si pretendon prokuroria.

Nga provat e administruara rrjedh pa dyshim se të gjithë të akuzuarit, ashtu si edhe përshkruan prokuroria, ishin prezent gjatë bisedave të zhvilluara me të dëmtuarit në vendet dhe ambientet e ndryshme të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, duke ndërmarrë veprimet për të kanosur dhe detyruar të dëmtuarit që të veprojnë në dëm të pasurisë së tyre, sipas kërkesave dhe kushteve të përcaktuar nga të akuzuarit por jo se të akuzuarit ishin ndarë në rolet për të përcaktuar ekzistimin e grupit të strukturuar si pretendon prokuroria në ankesë, por në formën e bashkëkryerës me kontributet konkrete të tyre për kryerjen e veprës penale, për të cilat gjykata e shkallës në aktgjykimin e ankimuar ka dhënë arsyet të mjaftueshme dhe të drejta në këtë drejtim, për të cilat edhe kjo gjykatë pajtohet me konkludimet e tilla si të drejta dhe ligjore.

Gjykata e Apelit pajtohet me përfundimin e gjykata e shkallës së parë si në aktgjykimin e ankimuar se në raport me piken II të dispozitivit të aktakuzës, ku të akuzuarit akuzohen se kanë bërë presion të vazhdueshëm në të dëmtuarin A.H, përpos se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar për kryerjen e veprës penale edhe nga vet dëshmia e dëshmitarit-dëmtuarit A.H, vërtetohet se të akuzuarit në asnjë rrethanë nuk mundë të vërtetohet se kanë përdorur forcën apo kërcënimet serioze si dy elemente të veprës penale detyrimi nga neni 267 i KPK-së, gjithashtu është vërtetuar edhe fakti se me –Aktvendim të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP/II.nr..... i dt..... si dhe Aktvendimi mbi pushimin hetimeve, P.nr.... prej datës ... është hudhur kallëzimi penal ndaj A.B si i dyshuar, ndërsa në cilësinë e të dëmtuarit A.H, ku sipas këtij aktvendim është konstatuar se raportet e dyja palëve është përshkruar se kanë cilësinë e raporteve juridike-civile,

praktikisht prokuroria në dispozitiv dhe arsyetim të akuzës flet për periudhën njëjtë për rrethana faktike të njëjta të kryerjes së veprës penale, si dhe me njoftimin nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, PP.II.nr....., të datës ....., ku në përmbajtjen e këtij njoftimi konstatohet se në mungesë të elementëve të veprës penale kanë pushuar hetimet sa i përket rastit të lartcekur dhe pretendimeve të aktakuzës-së.

Kolegji i kësaj gjykate vlerëson se në aktgjykimin e ankimuar janë dhënë vlerësimet për rrethanat faktike dhe është shpjeguar se këto rrethana në ndërlidhje me faktet dhe provat e tjera dhe nga tërësia e tyre është nxjerrë përfundimi i drejtë dhe ligjor që dëshmojnë veprimet inkriminuese e të akuzuarve në kryerjen e veprës penale për të cilën janë shpallur fajtor andaj për rrjedhojë, Gjykata e Apelit e Kosovës nga arsyet e shpjeguara më lartë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike.

#### Pretendimet lidhur me shkeljen e ligjit penal

Mbrojtësi i të akuzuarit A.B av.Illir Hoxhaj e ka atakuar aktgjykim edhe as i përket shkeljes së ligjit penal, me pretendimin që veprimet e të akuzuarve nuk e përbejnë figurën e veprës penale përkatësisht elementet e saj ngase nga provat e administruara janë vërtetuar faktet se të akuzuarit nuk e kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuari.

Gjykata e Apelit gjen se pretendimet për shkelje të ligjit penal janë të paqëndrueshme se me aktgjykimin e ankimuar nuk është shkelur ligji penal siç pretendon mbrojtësit i A. B, av.Illir Hoxhaj, për faktin se në gjendjen faktike të provuar rrjedh padyshim se në veprimet e të akuzuarve formësohen tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën janë shpallur fajtor se për këtë veprë penale të njëjti janë penalisht përgjegjës, si dhe nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të akuzuarve.

Aktakuza i ka ngarkuar me veprën penale të akuzuarin A, Krimi i organizuar nga neni 274 par.3 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës lidhur me veprën penale Detyrimi nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK-së. Të akuzuarit O e S.B, Krimi i organizuar nga neni 274 par.1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës lidhur me veprën penale Detyrimi nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Gjykata e Apelit rithekson se në këtë çështje penale pajtohet me përfundimin dhe konkludimin e gjykatës së shkallës së parë se në këtë çështje penale nuk janë vërtetuar elementet e veprës penale të Krimin të Organizuar nga neni 274 të KPK-së, pra figura e kësaj vepre penale si organizimi, formimi dhe mbikëqyrja pastaj që grupi të jetë i organizuar apo i strukturuar pra, nuk është vërtetuar se të pandehurit kanë pasur një udhëheqës të grupit, ata të kenë ndarë rolet me qëllim të kryerjes së veprës penale. Mirëpo, kjo Gjykatë gjen të gabuar pjesën e interpretimit ligjor, si në fq.45, nga gjykata se shkallës së parë se për ekzistimin e elementit të veprës penale të Krimin të Organizuar nga neni 274 të KPK-ës, se vepra themelore penale e Detyrimi nuk është e dënueshme me burgim prej së paku 4 vjet, por vepra themelor penale e Detyrimi dënohet nga 1 vjet deri në 10 vjet.

Gjykata e Apelit rikujton se formulimi i kësaj dispozite, nenin 274 par.7 pika “3) *Shprehja “krim i rëndë” do të thotë vepër penale që dënohet me burgim prej së paku katër vjet*”, nënkupton se është fjala për mundësin e shqiptimit të dënimit nga gjykata prej së paku katër vite për atë vepër penale e jo se kërkon që sipas ligjit të jetë e parashikuar minimumi i dënimit prej 4 vite për veprën penale që të konsiderohet në kuptim të shprehjes të cituar si më lartë, pra sipas kësaj dispozite kërkohet që për atë vepër penale të jetë e mundshme, brenda minimumit dhe maximumit të dënimit, të shqiptohet dënimi me burgim prej së paku katër vjet.

#### Të gjeturat për vendimin mbi dënimin

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e prokurorisë për një dënim me të ashpër, dhe ato të mbrojtëseve për lirim nga dënimi nuk janë të bazuara.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka marrë parasysh dhe ka vlerësuar drejt të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit konform nenit 64 të KPK-së. Për të akuzuarit si rrethana lehtësuese ka marrë parasysh rrethanat e tyre familjare, që të tre të pandehurit janë të martuar dhe kanë fëmijë, ndërsa si rrethana rënduese të cilat kanë ndikuar në përcaktimin e lartësisë së dënimit ka vlerësuar, për të akuzuarin A.B shkallë më të lartë të pjesëmarrjes së tij në kryerjen e veprës penale, dhe të njëjtit i përcaktoj dënim burgimi më të lartë, meqenëse ky i akuzuar është protagonist në të gjitha ngjarjet që lidhen me veprën penale për të cilën janë shpallur fajtor të pandehurit, ndërsa i akuzuari O.B ka pasur rol të theksuar në shkaktimin e kërcënimit të rëndë për të dëmtuarit, por edhe rol të drejtpërdrejtë në inkasimin e mjeteve materiale të kundërligjshme, nga bizneset që kishin marrë lokalet me



qira, kurse për të akuzuarin S.B ka gjetur se në veprimet e tij manifestohet shkallë me e ulët e pjesëmarrjes në kryerjen e veprës penale, roli i tij ka qenë kryesisht në shkaktimin e kërcënimit të rëndë ndaj të pandehurve, dhe atë e ka bërë në mënyrë të tërthortë, por gjithsesi me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore. Duke i pasur parasysh rrethanat e lartcekura të akuzuarve iu ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë, dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet e prokurorisë se sanksioni penale është tepër i butë, ndërsa në anën tjetër nuk ceket ndonjë rrethanë rënduese që do të justifikonte shqiptimin e një dënimi me të ashpër, kurse disa nga pretendimet në të cilat thirren mbrojtësit e të akuzuarit kanë qenë objekt vlerësimi nga gjykata e shkallës së parë, janë peshuar në mënyrën e duhur, si të tilla nuk kanë ndikim që të akuzuarve t'i shqiptohet një dënim tjetër nga ai i cilin është shqiptuar apo që të akuzuarit të lirohen nga vepra penale në mungesë të prevave, sikurse që pretendohet në ankesë e mbrojtëseve, kur merret parasysh vepra penale, kjo gjykatë vlerëson se këto rrethana në unitetin e tyre japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Nga arsyet e sipër cekura dhe në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

### **DEPARTAMENTI SPECIAL**

**APS.nr.40/2022**

**Datë: 20.01.2023**

Bashkëpunëtorja Profesionale,

Anëtarët e kolegjit,

Kryetar i kolegjit,

\_\_\_\_\_  
Syzana Goxhuli

\_\_\_\_\_  
Vaton Durguti

\_\_\_\_\_  
Bashkim Hyseni

\_\_\_\_\_  
Burim Ademi